**URDHER**
**Nr.15, date 18.8.2026**

**PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekt i këtij udhëzimi është orientimi dhe koordinimi i zbatimit të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi, për organizimin, realizimin, monitorimin dhe raportimin e veprimtarive të institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar gjatë vitit shkollor 2026-2027.

KREU II
ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I PROCESIT MËSIMOR

Neni 2
**Regjistrimi i nxënësve**

Regjistrimet e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar (IAP) të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi që përcakton moshën dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 3
**Pajisja me tekste shkollore**

1. Drejtoritë e IAP-ve, bazuar në udhëzimin nr. 7, datë 7.4.2022, "Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, të afishojnë në vend të dukshëm listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit për çdo klasë, vendi ku do të shpërndahen tekstet, si dhe periudha e shpërndarjes sipas një grafiku për çdo klasë.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e IAP-ve dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:
a) procesin e shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit para fillimit të procesit mësimor;
b) procesin e pajisjes me tekste shkollore falas për klasat I-V dhe në përdorim falas për klasat VI-IX të arsimit bazë publik, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në VKM-në përkatëse;
c) të sigurojnë pajisjen e nxënësve të klasave 1, 6 dhe 10 me tekstet shkollore të reja ose të përditësuara në vitin 2026, sipas Katalogut të Teksteve Shkollore për vitin shkollor përkatës.

3. AKAP të raportojë zyrtarisht në MA, brenda datës 20.09.2026, për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore, me fokus kategoritë e veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

**Mësimi i gjuhëve të huaja**

1. DRAP/ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, bazuar në marrëveshjet dhe memorandumet e përcaktuara në nenin 26 të këtij udhëzimi, të marrin masa për organizimin dhe vijueshmërinë e mësimit të gjuhëve të huaja në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë.

2. Në arsimin bazë:

a) të sigurohet vijimësia brenda shkollës e gjuhës së huaj të nisur në klasën I të arsimit fillor dhe e gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI;

b) të sigurohet vijimësia brenda shkollës e gjuhës së huaj (frënge, italiane dhe/ose gjermane) të nisur në klasën III të arsimit fillor, sipas marrëveshjeve dypalëshe të MA-së me ambasadat përkatëse;

c) DRAP-të, për çdo ZVAP në varësi, të raportojnë planifikimin për secilën gjuhë të huaj në AKAP, e cila brenda datës 30 shtator 2026 raporton në MA.

Neni 5

**Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

1. DRAP/ZVAP-të dhe IAP-të të sigurojnë me përparësi:

a) informimin dhe angazhimin e institucioneve arsimore për të lehtësuar procesin e trajnimit të mësuesve në arsimin fillor (AF), arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë (AML), me synim forcimin e kapaciteteve profesionale në fushat e edukimit shëndetësor, mjedisor, qytetar dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në mbështetje të procesit mësimor dhe veprimtarive edukative të shkollës;

b) informimin për zbatimin e urdhrit të përbashkët nr. 335, datë 14.7.2021, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për miratimin e rregullores për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë";

c) zbatimin e urdhrit të përbashkët nr. 336, datë 14.7.2021, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare";

ç) nxitjen e një jetese të shëndetshme dhe ndërgjegjësimin mjedisor të nxënësve përmes veprimtarive edukative dhe jashtëshkollore;

d) zbatimin e qasjes ndërdisiplinore STEM me qëllim formimin e nxënësve të aftë për mendim kritik, zgjidhje problemesh dhe përballimin e sfidave të zhvillimit teknologjik dhe mjedisor në shekullin XXI.

KREU III

MBROJTJA, SIGURIA DHE MIRËQENIA E NXËNËSVE

Neni 6

**Reduktimi i braktisjes shkollore**

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të zbatojnë me përgjegjësi:

a) Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit (MA), Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) dhe Ministrisë së Brendshme (MB), nr. 7522 prot., datë 12.07.2018 "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore";

b) Urdhrin e përbashkët të MA, MB dhe MShMS nr. 292, datë 28.5.2019 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive 'Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor'".

2. Drejtoritë e shkollave raportojnë në mënyrë të detajuar mbi rastet e braktisjes apo të rrezikut të braktisjes së shkollës nga nxënësi. Çdo rast raportohet menjëherë në zyrën vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) dhe vihet në dijeni njësia administrative në bashkinë përkatëse për ndjekjen e përbashkët dhe adresimin në strukturat përgjegjëse.

3. Drejtoritë e shkollave të evidentojnë dhe të raportojnë edhe rastet e transferimeve nga një shkollë në një tjetër apo të largimit të nxënësve për arsye të migrimit të familjes dhe të ndryshimit të vendbanimit, duke i klasifikuar në një kategori të veçantë dhe duke i raportuar në ZVAP.

4. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:

a) të monitorojnë shkollat lidhur me raportimin e nxënësve braktisës dhe të atyre në rrezik të braktisjes;

b) të trajnojnë drejtuesit e shkollave për raportimin në kohë të rasteve të braktisjes apo të riskut të braktisjes së shkollës nga nxënësit dhe protokollet e ndjekjes në rastet kur konstatohet braktisja;

c) të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe organizatave të shoqërisë civile, për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;

ç) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar apo të strehuar pranë institucioneve që bëjnë pjesë në Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik dhe të zbatojnë procedurat e ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;

d) të raportojnë në drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore. DRAP-të të raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), e cila përcjell raportin në MA në fund të çdo viti dhe sa herë është e nevojshme.

Neni 7

**Orientimi dhe informimi i nxënësve në ditën e parë të vitit shkollor**

1. Në ditën e parë të vitit shkollor 2026–2027, në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private, veprimtaria mësimore dhe edukative do të fokusohet në orientimin dhe njohjen e nxënësve me rregullat, normat e sjelljes dhe organizimin e institucionit arsimor.

2. Në çdo klasë, nxënësit njihen me:

a) rregulloren e brendshme të institucionit arsimor, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe rregullat e sjelljes në mjediset e shkollës;

b) rregullat dhe masat për ndalimin e përdorimit të telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të, në zbatim të udhëzimit nr. 23, datë 1.9.2025;

c) kodin e veshjes së nxënësve në institucionin arsimor;

ç) rregullat e sigurisë, respektimit të njëri-tjetrit dhe bashkëjetesës në komunitetin shkollor.

3. Informimi dhe orientimi i nxënësve realizohet nga të gjithë anëtarët e stafit të institucionit arsimor, sipas rolit dhe përgjegjësive të tyre, përfshirë mësuesit e të gjitha lëndëve, mësuesit kujdestarë, shërbimin psiko-social, oficerët e sigurisë dhe punonjësit e tjerë të institucionit.

Çdo anëtar i stafit kontribuon në përforcimin e njohjes, kuptimit dhe zbatimit të rregullave nga nxënësit si dhe të veprimtarive mësimore dhe pas shkolle që do të zhvillojë institucioni arsimor gjatë vitit shkollor.

4. Stafi i institucionit arsimor siguron edhe orientimin e nxënësve në mjediset e shkollës, duke i njohur ata me klasat, laboratorët, bibliotekën, mjediset sportive, hapësirat e përbashkëta, mjediset e shërbimit psiko-social, hapësirat e sigurisë dhe çdo mjedis tjetër në funksion të procesit mësimor dhe edukativ.

5. Për nxënësit që regjistrohen për herë të parë në institucionin arsimor, orientimi përfshin edhe njohjen me strukturën e institucionit, shërbimet që ofron, personat përgjegjës dhe mënyrën e kërkimit të ndihmës dhe mbështetjes.

6. Drejtoria e institucionit arsimor organizon dhe koordinon veprimtaritë e përcaktuara në këtë nen, duke siguruar angazhimin e të gjithë stafit dhe vijimësinë e mesazheve informuese dhe edukuese gjatë ditës së parë të vitit shkollor.

Neni 8

**Parandalimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore**

1. DRAP/ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të marrin masa për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit "Për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi dhe rritjen e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare", miratuar me urdhrin nr. 32, datë 21.1.2025, duke ndjekur me përparësi:

a) zbatimin e urdhrit nr. 435, datë 4.9.2025, "Për miratimin e Kodit të Etikës së mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar";

b) planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuese me fokus parandalimin dhe minimizimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore;

c) ngritjen e këndit "Stop dhunës në shkollë";

ç) ngritjen e ekipeve "antibulling" në çdo shkollë;

d) monitorimin dhe përmirësimin e punës së komisioneve të disiplinës dhe të komisioneve të etikës dhe të sjelljes, për trajtimin e rasteve të çdo lloji dhune në institucionet arsimore;

dh) organizimin, më datë 21 nëntor, të veprimtarive ndërgjegjësuese për "Ditën Kombëtare kundër bullizmit";

e) konsolidimin e rrjetit të mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar;

ë) raportimin periodik në DRAP dhe raportimin, brenda datës 30.5.2027, në AKAP, sipas formateve të përcaktuara, të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuara nga komisionet e etikës, si dhe të raportit informues për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

2. Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për parandalimin e dhunës në shkollë dhe raportimin periodik të çdo shkolle në ZVAP/DRAP/AKAP dhe në MA;

3. DRAP/ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare të marrin masa për zbatimin e protokolleve për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës në institucione arsimore parauniversitare, miratuar me urdhrin nr. 115, datë 22.4.2026, "Për miratimin e protokollit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës në institucione arsimore parauniversitare".

4. AKAP-i, pasi merr informacion nga DRAP-të, harton raportin për veprimtaritë e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe e dërgon në MA, brenda datës 1.7.2027.

5. Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë mes stafit, komunitetit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për krijimin e një modeli motivues të sjelljes së fëmijëve, mësuesve dhe prindërve në mjediset e shkollës dhe jashtë saj.

Neni 9
**Ndalimi i përdorimit të telefonit celular**

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të marrin masa për zbatimin e udhëzimit nr. 23, datë 1.9.2025, "Për përcaktimin e rregullave dhe masave për ndalimin e përdorimit të telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare".

2. Drejtoritë e shkollave të përfshijnë në rregulloret e tyre të brendshme masat shtesë për zbatimin korrekt të këtij udhëzimi.

Neni 10
**Shërbimi psiko-social**

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) të marrin masa për:

a) ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social (ShPS), në zbatim të urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit nga shërbimi psiko-social", të ndryshuar;

b) monitorimin e realizimit të planit të punës së njësive të ShPS-së, në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Cilësisë së Shërbimit Psiko-social dhe raportimin në AKAP në muajt janar dhe qershor 2027, për realizimin e tij. AKAP-i të raportojë në MA në muajt shkurt dhe korrik 2027.

c) funksionimin e rrjeteve profesionale të shërbimit psiko-social.

2. Puna e punonjësve të ShPS-së në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në:

a) "Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkollor", miratuar në qershor 2022;

b) "Udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor (rishikuar)", miratuar me urdhrin nr. 44, datë 26.8.2025;

c) "Parimet e etikës profesionale të shërbimit psiko-social shkollor (rishikuar)", miratuar me urdhrin nr. 412, datë 26.8.2025;

ç) "Protokollin e procesit të supervizimit profesional të shërbimit psiko-social shkollor", miratuar me urdhrin nr. 116, datë 22.4.2026.

Neni 11
**Oficeri i sigurisë**

1. Puna e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në:

a) udhëzuesin për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë (rishikuar);

b) parimet e etikës profesionale të oficerëve të sigurisë në shkolla;

c) urdhrin nr. 343, datë 7.7.2026 "Për miratimin e standardeve profesionale të oficerëve të sigurisë në shkolla";

ç) urdhrin nr. 344, datë 7.7.2026 "Për miratimin e kornizës së vlerësimit të cilësisë së shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla";

d) urdhrin nr. 345, datë 7.7.2026 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të shërbimit të oficerëve të sigurisë në shkolla".

KREU IV
ZHVILLIMI PROFESIONAL, ADMINISTRIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Neni 12
**Zhvillimi profesional dhe portofoli digjital i mësuesit**

1. Drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare të ndjekin me përparësi plotësimin në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) të portofolit digjital nga të gjithë mësuesit e arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë.

2. Mësuesit, brenda muajit tetor, të ngarkojnë në portofolin digjital në SMIP të gjitha certifikatat, trajnimet, konferencat, kreditet e fituara, pjesëmarrjet në aktivitete të certifikuara, kualifikimet profesionale etj.

3. Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore të zbatojnë urdhrin nr. 100, datë 25.2.2022, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar.

4. Drejtori i shkollës dhe mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të hartojnë Planin e Zhvillimit Profesional trevjeçar për mësuesit e shkollës, bazuar në vlerësimin individual të nevojave për trajnim të identifikuara nga monitorimi periodik i kryer.

5. Drejtori i shkollës kujdeset që, në bashkëpunim me nëndrejtorin/nëndrejtorët, mësuesit koordinatorë të cilësisë dhe mësuesit, të përdorin SMIP për të monitoruar ecurinë e zhvillimit profesional përmes portofolit digjital të mësuesit, ku duhet të pasqyrohet çdo vit dhe sa herë është e nevojshme informacioni për zhvillimin profesional të mësuesit, sipas standardeve të përcaktuara nga MA dhe ASCAP.

6. AKAP, përmes DRAP/ZVAP-ve:

a) koordinon bashkëpunimin me drejtoritë e shkollave dhe mësuesit koordinatorë të cilësisë për zhvillimin e trajnimeve për mësuesit sipas lëndëve dhe ciklit arsimor, bazuar në Programin Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve në bashkëpunim me IAL-të;

b) monitoron plotësimin e portofolit digjital të mësuesit në SMIP në çdo shkollë dhe kujdeset që trajnimet e planifikuara nga ASCAP-i të përputhen me nevojat e dala nga vlerësimet e shkollës (drejtori dhe koordinatori i cilësisë), nga ZVAP-të nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar, si dhe nga AKAP/DRAP nëpërmjet monitorimeve, inspektimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara në institucionet arsimore.

7. DRAP/ZVAP-të:

a) publikojnë në faqen e internetit listën e institucioneve arsimore parauniversitare, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale;

b) hartojnë listat e IAP-ve, publike dhe/ose private, në juridiksion të tyre, në të cilat do të zhvillohet praktika profesionale, listat e praktikantëve dhe listat e mentorëve;

c) sigurojnë kryerjen e praktikës profesionale nga praktikantët, sipas procedurave të rregullores së praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit;

ç) monitorojnë organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në IAP.

Neni 13

**Dokumentimi i planeve dhe i rregullores së shkollës përmes SMIP-it**

1. Drejtori i shkollës, pas miratimit, ngarkon në SMIP, në hapësirën e dedikuar, planin afatmesëm të shkollës, planin vjetor të veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore të shkollës, rregulloren e brendshme, planin e zhvillimit profesional dhe çdo dokument tjetër të përcaktuar në këtë udhëzim, brenda muajit nëntor të vitit mësimor.

2. Plani vjetor i veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore të shkollës dhe rregullorja e brendshme e shkollës janë të aksesueshme nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore përmes SMIP-it.

3. Psikologu, punonjësi social dhe oficeri i sigurisë ngarkojnë në SMIP planet vjetore të punës dhe dokumentet përkatëse, brenda muajit tetor të vitit mësimor.

4. Koordinatori i cilësisë dhe koordinatori i karrierës ngarkojnë në SMIP planet vjetore të punës dhe dokumentet përkatëse, brenda muajit tetor të vitit mësimor.

5. Mësuesit ngarkojnë në SMIP planet vjetore dhe dokumentet e kërkuara nga drejtoria, brenda muajit shtator të vitit mësimor.

6. Të gjitha të dhënat që raportohen sipas këtij udhëzimi administrohen nëpërmjet SMIP-it, kur funksionalitetet përkatëse janë të disponueshme.

Neni 14

**Karta e Performancës**

1. Për Kartën e Performancës së vitit shkollor 2025-2026 dhe të vitit shkollor 2026-2027:

a) shkollat të llogarisin edhe ndryshimet në vlerë për treguesit e pasqyruar një vit më parë;

b) në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në udhëzuesin për Kartën e Performancës së shkollës;

c) institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo, p.sh. të dhëna për lëndët me zgjedhje, arritjet e nxënësve me AK etj.;

ç) çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 3.9.2026, të plotësojë Kartën e Performancës së shkollës për vitin shkollor 2025-2026, si dhe ta bëjë atë publike për personin që ushtron përgjegjësinë prindërore dhe komunitetin;

d) ZVAP-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.9.2026;

dh) në fund të muajit shtator 2026, ZVAP-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;

e) shkollat të hartojnë Kartën e Performancës për vitin shkollor 2026-2027 me treguesit e përzgjedhur, bazuar në urdhrin nr. 157, datë 28.3.2022;

ë) çdo shkollë e arsimit parauniversitar të llogarisë edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës së vitit paraardhës.

Neni 15

**Vlerësimi dhe menaxhimi i Riskut në Institucionet Arsimore Parauniversitare**

1. ZVAP-ja, në funksion të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut, ka për detyrë:

a) Të caktojë koordinatorët e riskut, të hartojë kalendarin e mbledhjes së të dhënave dhe të realizojë vlerësimin e riskut për çdo IAP, duke kombinuar dëshmitë dokumentare me vëzhgimin fizik dhe anketimet.

b) Të hartojë dhe administrojë regjistrat e riskut (individualë dhe në nivel ZVAP), duke klasifikuar shkollat sipas shkallëve të riskut.

c) Të përcjellë regjistrat pranë DRAP, AKAP dhe ASCAP brenda muajit korrik.

ç) Të ofrojë mbështetje profesionale për adresimin e risqeve të identifikuara për çdo IAP nën juridiksionin e saj.

2. Drejtuesi i IAP-së, në funksion të menaxhimit të riskut, ka për detyrë:

a) Të përcjellë në ZVAP të dhëna të sakta dhe të përditësojë në kohë reale regjistrin e riskut të institucionit.

b) Të hartojë planin e masave për trajtimin e faktorëve të riskut.

c) Të diskutojë gjetjet me stafin, bordin e shkollës dhe këshillin e prindërve.

ç) Të afishojë progresin e masave dhe të koordinohet me aktorët lokalë (bashki, polici, shërbime shëndetësore) për risqet jashtë kompetencës së shkollës.

d) Të raportojë periodikisht në ZVAP mbi efektivitetin e masave të ndërmarra për reduktimin dhe eliminimin e risqeve.

KREU V
VEPRIMTARITË SIPAS NIVELEVE DHE LLOJEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 16
**Arsimi parashkollor**

1. AKAP, DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), të marrin masa për:

a) krijimin dhe përmirësimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të institucioneve arsimore parashkollore, që të mundësojnë zhvillimin dhe edukimin cilësor, të sigurt, miqësor dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve;

b) rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve 3-6 vjeç në arsimin parashkollor;

c) regjistrimin me përparësi në institucionet arsimore parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.), të kthyer nga emigracioni, fëmijë me aftësi të kufizuara, viktima apo viktima të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore;

ç) vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit të institucioneve arsimore parashkollore me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me komunitetin, për krijimin e një modeli motivues të sjelljes për të gjithë aktorët e përfshirë;

d) lehtësimin e tranzicionit të fëmijëve nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet kopshteve, shkollave dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, me synim krijimin e një kalimi të qetë, të sigurt dhe mbështetës për fëmijët;

dh) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve 3-6 vjeç me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi;

e) hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara nga mësuesit e arsimit parashkollor, në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, me psikologë, punonjës socialë dhe profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara;

ë) pajisjen e fëmijëve që përfundojnë grupin e tretë të arsimit parashkollor ose klasën përgatitore dhe kanë moshën për të ndjekur klasën e parë të arsimit bazë, me vërtetimin e ndjekjes së arsimit parashkollor për grupin përkatës, të nënshkruar nga drejtuesi i institucionit të arsimit parashkollor;

f) ngritjen në çdo institucion arsimor parashkollor të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve, komisionit të etikës dhe të sjelljes dhe komisionit të disiplinës sipas legjislacionit në fuqi.

2. Këshillat e mësuesve dhe rrjetet profesionale të trajtojnë me përparësi temat e mëposhtme:

a) Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.

b) Kurrikula me kompetenca dhe planifikimi në arsimin parashkollor.

c) Portofoli i të nxënit.

ç) Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor.

d) Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor.

dh) Standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore.

e) Arsimi gjithëpërfshirës.

ë) Mësimdhënia me fëmijën në qendër.

f) Ndërgjegjësimi i personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç.

g) Gatishmëria e fëmijëve të kopshtit për shkollë.

gj) Vlerësimi i brendshëm i kopshtit.

h) Plani afatmesëm dhe plani vjetor i kopshtit.

i) Zhvillimi profesional i mësuesit dhe i drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor, faktor në rritjen e cilësisë së shërbimeve për fëmijët 3-6 vjeç.

Neni 17

**Arsimi bazë**

1. AKAP/DRAP/ZVAP-të në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të sigurojnë:

a) marrjen e masave për krijimin në shkollë të mjediseve të jashtme dhe të brendshme të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, që nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të drejtë dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) regjistrimin me përparësi në shkollë të fëmijëve nga shtresat në nevojë, nga pakicat kombëtare, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të fëmijëve të kthyer nga emigracioni, si dhe të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore;

2. AKAP/DRAP/ZVAP-të në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të sigurojnë:

a) zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar;

b) zbatimin e planit mësimor për klasat II-V dhe VII-IX, miratuar me urdhrin nr. 203, datë 25.4.2023 "Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë";

c) zbatimin e planit mësimor për klasën e parë dhe klasën e gjashtë, miratuar me urdhrin nr. 554, datë 28.10.2025 "Për miratimin e planit mësimor të arsimit bazë";

ç) zbatimin e planit mësimor për klasat II-V dhe VII-IX për pakicat kombëtare në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 531, datë 9.9.2022 "Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë";

d) zbatimin e planit mësimor për klasën e parë dhe klasën e gjashtë, miratuar me urdhrin nr. 379, datë 20.7.2026 "Për miratimin e planit mësimor të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët në arsimin bazë për pakicat kombëtare";

dh) zbatimin e planit mësimor për klasat II-V dhe VII-IX për arsimin bazë me kohë të pjesshme, miratuar me urdhrin nr. 284, datë 28.7.2021;

e) zbatimin e planit mësimor për klasën e parë dhe klasën e gjashtë, miratuar me urdhrin nr. 380, datë 20.7.2026 "Për miratimin e planit mësimor të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët, në arsimin bazë me kohë të pjesshme";

ë) zbatimin e planit mësimor për klasat II-V dhe VII-IX të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 305, datë 16.6.2023 "Për miratimin e planit mësimor të klasave të caktuara me drejtim artistik, në arsimin bazë";

f) zbatimin e programeve lëndore për klasën e parë dhe klasën e gjashtë, të miratuara me urdhrin nr. 555, datë 28.10.2025 "Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë, të disa klasave të arsimit bazë", të cilat hyjnë në fuqi dhe zbatohen për herë të parë në vitin shkollor 2026–2027;

g) përdorimin e materialeve mbështetëse për zbatimin e programeve lëndore të klasës së parë dhe të klasës së gjashtë, të hartuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), përkatësisht: Modulet kurrikulare për kurrikulën në bazë shkolle, Udhëzuesit për Nivelet e Arritjeve dhe Udhëzuesit për Veprimtaritë Praktike për të gjitha fushat e të nxënit/lëndët e klasës së parë dhe të klasës së gjashtë;

gj) zbatimin e programeve të lëndës së TIK-ut në shkollat e pajisura me Laboratorë Smart, për klasat përkatëse sipas akteve miratuese në fuqi, përfshirë programin për klasën II, miratuar me shkresën nr. 2608/2 prot., datë 8.5.2023, programin për klasën III, miratuar me urdhrin nr.

267, datë 3.6.2024 dhe programin për klasën IV në shkollat e mbështetura nga projekti "Element IT", miratuar me urdhrin nr. 344, datë 21.7.2025, si dhe në shkollat e tjera ku janë ndërtuar Laboratorë Smart në kuadër të financimeve të ndryshme dhe me partnerë zhvillimorë të MA-së;

h) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin/përcaktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi;

i) hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara;

j) zbatimin e urdhrit nr. 32, datë 3.2.2026 "Për miratimin e metodologjisë dhe instrumentet për vlerësimin e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor parauniversitar";

k) zbatimin e urdhrit nr. 410, datë 26.8.2025 "Për miratimin e metodologjisë dhe instrumentet për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar";

l) zbatimin e urdhrit nr. 268, datë 28.8.2020 "Për miratimin e Metodologjisë së vlerësimit të brendshëm të shkollës";

ll) ngritjen dhe funksionimin, sipas legjislacionit në fuqi, të organizmave, si: Qeveria e Nxënësve dhe Parlamenti i Nxënësve;

m) zbatimin nga institucionet arsimore të planit të veprimit të hartuar prej tyre (DRAP/ZVAP) për mbështetjen e arsimimit në gjuhën amtare të fëmijëve të pakicave kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

n) planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të veçanta në institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare;

nj) ndjekjen dhe përfundimin e arsimit bazë nga fëmijët romë, sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët;

o) nxitjen e zhvillimit të moduleve në bazë shkolle në institucionet arsimore ku ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh romë, me fokus njohjen e historisë, gjuhës dhe kulturës rome, edukimin ndërkulturor dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin;

p) funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve dhe mësuesve ndihmës;

q) zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe të provimeve kombëtare të arsimit bazë, në zbatim të udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse;

r) trajnimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të arsimit fillor, të gjuhës shqipe, të matematikës, të shkencave të natyrës dhe të gjitha profileve të tjera;

rr) koordinimin dhe realizimin e veprimtarive për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme dhe parandalimin e fenomeneve negative në shkollë, në zbatim të udhëzimit të përbashkët nr. 658, datë 23.9.2019 "Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij";

s) ndjekjen e arsimit bazë me kohë të pjesshme, sipas legjislacionit në fuqi;

sh) zbatimin e nismës "Tri lëndë në gjashtë orë", me vendimmarrje të vetë shkollës, në varësi të kushteve dhe specifikave të saj;

t) garantimin e mbështetjes institucionale dhe promovimin e Programit të Ekipeve Sportive në shkolla në bashkëpunim me KOKSH-in, si dhe krijimin e kushteve optimale për angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në Kampionatin Vjetor;

th) krijimin e klasave të profilizuara në sport, vetëm në fillim të vitit shkollor dhe vetëm pas miratimit nga DRAP-i përkatës, nëse shkolla plotëson kushtet e infrastrukturës, të pajisjeve sportive dhe të kapaciteteve profesionale të nevojshme.

3. DRAP/ZVAP-të raportojnë në AKAP dhe MA brenda afateve dhe kërkesave të të dhënave statistikore në arsimin bazë, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT;

4. Në institucionet e arsimit bazë që janë të pajisura me Laboratorë Smart, drejtuesit e IAP-ve sigurojnë përdorimin e tyre në funksion të përmirësimit të procesit mësimor për të gjithë nxënësit:

a) për zhvillimin e orës mësimore të lëndës "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)" për të gjitha klasat nga e para deri në të nëntën sipas një kalendari të mirëorganizuar nga drejtoria;

b) për zbatimin e metodave bashkëkohore, interaktive dhe të bazuara në simulime, veçanërisht në lëndët e shkencave të natyrës dhe matematikës;

c) për përdorimin me eficencë edhe nga mësuesit e tjerë sipas temave të caktuara, për lëndët STEM, gjuhë e huaj, lëndë shoqërore dhe projekte shkollore ndërdisiplinore;

ç) për monitorimin periodik nga DRAP/ZVAP-të të përdorimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së Laboratorëve Smart;

d) për raportimin e përdorimit dhe funksionimit të Laboratorëve Smart në përfundim të çdo periudhe mësimore nga drejtuesit e IAP-ve në ZVAP-et përkatëse, sipas formatit të miratuar nga DRAP-i.

Neni 18

**Gjimnazi**

1. AKAP, DRAP/ZVAP-të dhe drejtuesit e gjimnazeve, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të sigurojnë:

a) marrjen e masave për krijimin në shkollë të mjediseve të jashtme dhe të brendshme të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, që nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të drejtë dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) regjistrimin me përparësi të nxënësve nga pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane dhe përfundimin prej tyre të arsimit të mesëm të lartë;

2. AKAP/DRAP/ZVAP-të në bashkëpunim me drejtuesit e gjimnazeve të sigurojnë:

a) zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar;

b) zbatimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe udhëzimit të përbashkët nr. 28, datë 16.10.2023, "Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas", i ndryshuar.

c) zbatimin e planit mësimor të gjimnazit për klasën X, miratuar me urdhrin nr. 550, datë 28.10.2025 "Për miratimin e planit mësimor të gjimnazit", i cili zbatohet për herë të parë në vitin shkollor 2026-2027;

ç) zbatimin e planit mësimor të gjimnazit për klasat XI-XII, miratuar me shkresën nr. 12789/1 prot., datë 28.12.2017;

d) zbatimin e planit mësimor të gjimnazit me kohë të pjesshme për klasën X, miratuar me urdhrin nr. 381, datë 20.07.2026, "Për miratimin e planit mësimor të nivelit arsim i mesëm i lartë i gjimnazit me kohë të pjesshme";

dh) zbatimin e planit mësimor të gjimnazit me kohë të pjesshme për klasat XI-XIII, miratuar me shkresën nr. 7380 prot., datë 20.7.2016;

e) zbatimin e programeve lëndore për klasën e dhjetë, të miratuara me urdhrin nr. 556, datë 28.10.2025 "Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe të kurrikulës me zgjedhje, të arsimit të mesëm të lartë", të cilat hyjnë në fuqi dhe zbatohen për herë të parë në vitin shkollor 2026–2027;

ë) përdorimin e materialeve mbështetëse për zbatimin e programeve lëndore të klasës së X-të, të hartuara nga ASCAP, përkatësisht: Modulet kurrikulare për kurrikulën në bazë shkolle dhe kurrikulën me zgjedhje; Udhëzuesit për Nivelet e Arritjeve dhe Udhëzuesit për Veprimtaritë Praktike për të gjitha fushat e të nxënit/lëndët mësimore të klasës së X-të;

f) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës, në bazë të legjislacionit në fuqi;

g) zbatimin e urdhrit nr. 463, datë 30.8.2024, "Për përcaktimin e kritereve për miratimin e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", dhe raportimin periodik nga AKAP-i në MA mbi veprimtarinë e mësuesve koordinatorë;

gj) zbatimin e urdhrit nr. 32, datë 3.2.2026 "Për miratimin e metodologjisë dhe instrumentet për vlerësimin e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor parauniversitar";

h) zbatimin e urdhrit nr. 410, datë 26.8.2025 "Për miratimin e metodologjisë dhe instrumentet për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar";

i) zbatimin e urdhrit nr. 268, datë 28.8.2020 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të brendshëm të shkollës";

j) ngritjen dhe funksionimin sipas legjislacionit në fuqi të organizmave, si: Qeveria e Nxënësve dhe Parlamenti i Nxënësve;

l) zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore bazuar në rregulloren e Maturës Shtetërore 2027 dhe udhëzimet përkatëse.

3. DRAP/ZVAP-të raportojnë në AKAP dhe MA brenda afateve dhe kërkesave të të dhënave statistikore në arsimin bazë, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT.

Neni 19

**Arsimi parauniversitar privat**

1. AKAP, DRAP/ZVAP-të të realizojnë me përparësi detyrat si vijon:

a) të mbajnë kontakte me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor në fushën e arsimit dhe t'i monitorojnë për realizimin e planeve mësimore të miratuara dhe të programeve lëndore të përditësuara;

b) të kërkojnë dhe të administrojnë të dhëna statistikore që lidhen me procesin mësimor;

c) të bëjnë vlerësimin e kritereve të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MA;

ç) të sistemojnë nxënësit në rast mbylljeje të institucioneve arsimore private.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private të marrin masat e mëposhtme:

a) të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;

b) të zbatojnë rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe udhëzimin e përbashkët nr. 28, datë 16.10.2023, "Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas", i ndryshuar;

c) të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar;

ç) institucionet mund ta ndërpresin veprimtarinë e tyre arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë arsimore duhet të njoftojnë institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, AKAP-në, MA-në, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e plotë në ZVAP-të përkatëse.

3. Institucionet arsimore parauniversitare private që funksionojnë në gjuhë të huaj, të cilat lëshojnë diploma të tjera të ndryshme nga ato të Maturës Shtetërore, të bashkëpunojnë me ZVAP-të përkatëse për njoftimin në kohë të maturantëve që dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e procedurave të përcaktuara në rregulloren e Maturës Shtetërore të vitit përkatës dhe në udhëzimin nr. 9, datë 02.06.2026, "Për përcaktimin e procedurave të njësimit të diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, të lëshuara nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë të licencuara në Republikën e Shqipërisë".

4. Për maturantët që dëshirojnë të vijojnë studimet e larta jashtë vendit, institucionet arsimore private të bashkëpunojnë me përfaqësitë e huaja të shtetit përkatës për njohjen e kritereve të aplikimeve në institucionet e huaja të arsimit të lartë.

Neni 20
**Arsimi profesional**

1. Për institucionet e arsimit të mesëm profesional zbatohen përcaktimet e mëposhtme:

a) fusha e kulturës profesionale në arsimin e mesëm profesional, për vitin shkollor 2026-2027, rregullohet me akte të posaçme në përputhje me ligjin nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) për Maturën Shtetërore Profesionale të zbatohet rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, përfshirë Maturën Shtetërore Profesionale, dhe udhëzimet përkatëse, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

Neni 21
**Shkolla të arsimit të orientuar**

1. Për shkollat me status të veçantë dhe institucionet arsimore të orientuara, AKAP, DRAP/ZVAP-të dhe drejtuesit e institucioneve arsimore të sigurojnë zbatimin e akteve dhe planeve përkatëse, si më poshtë:

a) vendimin nr. 149, datë 13.3.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve të posaçme dhe procedurave për dhënien e statusit "shkollë me status të veçantë"";

b) urdhrin nr. 597, datë 16.12.2024 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shkollës me status të veçantë";

c) planin mësimor të niveleve "Arsim fillor" dhe "Arsimi i mesëm i ulët" të shkollës me status të veçantë "Koreografike", Tiranë, miratuar me urdhrin nr. 43, datë 12.2.2026;

ç) urdhrin nr. 353, datë 8.7.2026 "Për miratimin e planit mësimor për nivelin arsim i mesëm i lartë i orientuar sportiv, të shkollës me status të veçantë "Benardina Qerraxhia", Durrës", i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet për klasën X;

d) planin mësimor për klasat XI-XII të shkollës me status të veçantë “Benardina Qerraxhia”, Durrës, miratuar me shkresën nr. 4116/2 prot., datë 11.9.2020 me lëndë: “Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive)”;

dh) planin mësimor për nivelin arsimor të arsimit të mesëm të ulët, të shkollës me status të veçantë “Benardina Qerraxhia”, Durrës, miratuar me urdhrin nr. 387, datë 12.8.2025;

e) Urdhrin nr. 354, datë 8.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor për nivelin arsim i mesëm i lartë i orientuar sportiv, të shkollës së mesme të orientuar sportive “Loro Boriçi””, i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet për klasën X;

ë) planin mësimor për klasat XI-XII të shkollës së orientuar sportive “Loro Boriçi”, miratuar me shkresën nr. 5418 prot., datë 26.5.2016 me lëndë: “Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar “sportiv”, viti shkollor 2016-2017";

f) zbatimin, në klasat I dhe IV, të urdhrit nr. 356, datë 8.7.2026, “Për miratimin e planit mësimor për klasa të caktuara me drejtim artistik, të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët, në arsimin bazë, dega “Muzikë””;

g) urdhrin nr. 378, datë 20.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor për nivelin arsim i mesëm i lartë i orientuar me drejtim artistik”, i cili zbatohet për klasën X të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik;

gj) urdhrin nr. 306, datë 16.6.2023 “Për miratimin planit mësimor për institucionet arsimit të mesëm të orientuar me drejtim artistik”, i cili zbatohet për klasat XI-XII të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë të orientuar me drejtim artistik;

h) Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me orientim gjuhësor të sigurohet zbatimi i akteve dhe planeve përkatëse, si më poshtë:

i) urdhrin nr. 357, datë 8.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor për nivelin arsimi i mesëm i lartë i orientuar, drejtimi “Gjuhët e huaja””, i cili, në vitin shkollor 2026-2027, zbatohet për klasën X;

j) plani mësimor për klasat XI-XII, miratuar me shkresën nr. 5415 prot., datë 26.5.2016 me lëndë: “Plani mësimor arsimi i mesëm i orientuar, (gjuhët e huaja), viti shkollor 2016-2017”, i ndryshuar;

2. Institucionet arsimore mund të përzgjedhin tekste shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, jashtë Katalogut të Teksteve Shkollore 2026-2027, vetëm në rastet kur në këtë katalog nuk është miratuar dhe përfshirë asnjë tekst shkollor për lëndën përkatëse.

Neni 22

**Shkollat speciale dhe qendrat burimore**

1. Për shkollat speciale dhe qendrat burimore, AKAP/DRAP/ZVAP-të dhe drejtuesit e institucioneve arsimore të sigurojnë zbatimin e akteve dhe planeve përkatëse, si më poshtë:

a) Urdhrin nr. 352, datë 8.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët në arsimin bazë, për Qendrën Burimore, për nxënësit që nuk dëgjojnë”, i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet për klasën I dhe VI;

b) për klasat II-V dhe VII-IX të Qendrës Burimore “Për Nxënësit që nuk Dëgjojnë”, zbatohet plani mësimor i miratuar me urdhrin nr. 643, datë 13.11.2023 “Për miratimin e planit mësimor për arsimin bazë, për Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë”;

c) Urdhrin nr. 355, datë 8.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor për nivelin arsim i mesëm i lartë i orientuar “Teknologji dhe TIK” për Qendrën Burimore, për nxënësit që nuk dëgjojnë”, i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet në klasën X;

ç) për klasat XI dhe XII të arsimit të mesëm të lartë të orientuar “Teknologji dhe TIK” të Qendrës Burimore Për Nxënësit që nuk Dëgjojnë, zbatohet urdhri nr. 113, datë 27.2.2023, “Për

miratimin e planit mësimor për arsimin e mesëm të orientuar “Teknologji dhe TIK”, për nxënësit që nuk dëgjojnë”, i ndryshuar;

d) Urdhrin nr. 351, datë 08.07.2026 “Për miratimin e planit mësimor të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët në arsimin bazë, për Qendrën Burimore, për nxënësit që nuk shikojnë”, i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet për klasën I dhe VI;

dh) për klasat II-V dhe VII-IX të Qendrës Burimore “Ramazan Kabashi”, zbatohet plani mësimor i miratuar me urdhrin nr. 694, datë 18.11.2022 “Për miratimin e planit mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë”;

e) Urdhrin nr. 350, datë 8.7.2026 “Për miratimin e planit mësimor të niveleve arsim fillor dhe arsim i mesëm i ulët, në arsimin bazë, për shkollat speciale”, i cili në vitin shkollor 2026-2027 zbatohet për klasën I dhe VI;

ë) për klasat II-V dhe VII-IX, për shkollat speciale, zbatohet plani mësimor i miratuar me urdhrin nr. 366, datë 21.9.2021, “Për miratimin e planit mësimor të shkollave speciale”.

2. AKAP, DRAP/ZVAP-të dhe drejtuesit e institucioneve arsimore të marrin masat për:

a) ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të shkollave speciale dhe të qendrave burimore;

b) forcimin e rolit të qendrave burimore në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet arsimore parauniversitare për ofrimin e shërbimeve mbështetëse;

c) monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga shkollat speciale dhe qendrat burimore.

## KREU VI
## POLITIKA, STRATEGJI, PLANE KOMBËTARE, PROJEKTE DHE MARRËVESHJE INSTITUCIONALE

### Neni 23
### **Zbatimi i strategjive ndërsektoriale dhe kombëtare**

1. AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji ndërsektoriale ose kombëtare:

a) të caktojnë personat përgjegjës;

b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;

c) të monitorojnë realizimin e veprimtarive;

ç) të raportojnë rregullisht për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji;

d) të integrojnë masat dhe veprimtaritë që rrjedhin nga strategjitë në planin vjetor të institucionit arsimor dhe në planet e punës së strukturave përkatëse.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të mbështesin dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MA, ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për strategjitë e mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave;

b) Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, plani i veprimit dhe pasaporta e indikatorëve, miratuar me vendimin nr. 892, datë 27.12.2022 të Këshillit të Ministrave;

c) Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave;

ç) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin nr. 400, datë 30.6.2021 të Këshillit të Ministrave;

d) Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023 të Këshillit të Ministrave;

dh) Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i Veprimit 2025-2027, miratuar me vendimin nr. 606, datë 23.10.2025 të Këshillit të Ministrave;

e) Strategjia për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, miratuar me vendimin nr. 505, datë 30.6.2026 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe të planit të veprimit 2026-2028";

ë) Strategjia Kombëtare për Kulturën, 2026-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2026-2030, miratuar më datë 30.7.2026.

f) Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2026-2030 dhe Plani i Veprimit 2027-2029, miratuar me vendimin nr. 586, datë 22.7.2026 të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

**Zbatimi i planeve kombëtare të veprimit dhe agjendave kombëtare**

1. AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për planet kombëtare të veprimit dhe agjendat kombëtare që kanë masa në fushën e arsimit parauniversitar:

a) të identifikojnë detyrimet që rrjedhin për sistemin arsimor parauniversitar;

b) të planifikojnë veprimtaritë përkatëse në nivel rajonal, vendor dhe shkolle;

c) të monitorojnë zbatimin e masave;

ç) të raportojnë periodikisht në AKAP dhe MA për ecurinë e zbatimit;

d) të sigurojnë bashkëpunimin me institucionet dhe partnerët përkatës për realizimin e masave të planit të veprimit.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të monitorojnë dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MA, ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për planet dhe agjendat e mëposhtme:

a) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, miratuar me vendimin nr. 659, datë 3.11.2021 të Këshillit të Ministrave;

b) Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin nr. 412, datë 19.6.2019 të Këshillit të Ministrave;

c) Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, miratuar me vendimin nr. 429, datë 10.6.2026 të Këshillit të Ministrave;

ç) Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2026-2030), miratuar me vendimin nr. 496, datë 26.6.2026 të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

**Zbatimi i projekteve në sistemin arsimor parauniversitar**

1. AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për projektet që zbatohen në institucionet arsimore parauniversitare:

a) të koordinojnë zbatimin e veprimtarive me institucionet dhe partnerët përkatës;

b) të mbështesin institucionet arsimore për realizimin e aktiviteteve të parashikuara;

c) të monitorojnë zbatimin e projekteve në nivel shkolle, ZVAP-je dhe DRAP-i;

ç) të raportojnë në AKAP dhe MA për ecurinë e zbatimit.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të mbështesin dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MA, ecurinë e zbatimit të projekteve të mëposhtme:

a) Vlerësimi i projektit "Element IT", në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, miratuar me vendimin nr. 594, datë 7.9.2022 të Këshillit të Ministrave;

b) Projekti "Shkollat për shëndetin", në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, miratuar me vendimin nr. 521, datë 18.9.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme në shkolla – shkollat për shëndetin, faza e daljes 1 maj 2025 – 31 dhjetor 2027, një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi";

c) Projekti "Inteligjenca artificiale për të rinjtë", në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet MAS-it dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, me nr. 3877/1 prot., datë 3.6.2022;

ç) Paketa e Edukimit Zgjedhor dhe Qytetar për klasat 6-9 dhe 10-12 me mbështetjen e Këshillit të Europës;

d) Projekti "Përmirësimi i aftësive të jetës përmes integrimit të tyre në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë dhe udhëzimeve për karrierën në sistemin shkollor", i nënshkruar mes CFCU-së dhe UNICEF-it, në partneritet me Qendrën për Aftësi Konkurruese, financuar në kuadër të Programit Kombëtar IPA 2022, në zbatim të veprimit "Ndërtimi i aftësive, Formësimi i të ardhmes - Në rrugën drejt integrimit në BE".

3. Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe UNICEF-it, do të zbatohen në shkollat e përcaktuara aktivitetet si më poshtë:

a) Platforma Digjitale "Eduten" që shërben për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në matematikë, së bashku me udhëzimet për përdorimin e inteligjencës artificiale në institucionet arsimore.

b) Platforma Digjitale "Akelius" që shërben për zhvillimin e aftësive të nxënësve në gjuhët e huaja.

c) Zbatimi i nismës "Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm" për parandalimin e braktisjes shkollore.

ç) Zbatimi i iniciativës "Giga" për hartëzimin dhe monitorimin në kohë reale të aksesit dhe lidhjes me internet në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar.

4. Institucionet arsimore parauniversitare të dokumentojnë realizimin e aktiviteteve të projekteve dhe të ruajnë evidencat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 26
## **Zbatimi i marrëveshjeve dhe memorandumeve**

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MA, për ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për marrëveshjet dhe memorandumet e mëposhtme:

a) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve

të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë, mbi programin "Iliria", për mësimin e gjuhës italiane në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, nënshkruar në Tiranë, më 18.5.2021;

b) angazhimet për gjuhën frënge në kuadër të aderimit në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe Memorandumit të Partneritetit mbi "Bashkëpunimin Arsimor të Kuadrit Strategjik të Frankofonisë";

c) Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme të Republikës Franceze dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me seksionet dygjuhëshe shqip-frëngjisht dhe shkollat e tyre mbështetëse në Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 02.12.2025;

ç) Memorandumi i Mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi funksionimin e seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane, nënshkruar më 12.12.2019;

d) Memorandumi i Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë, mbi seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman dhe planet mësimore për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman, miratuar me shkresën nr. 7496 prot., datë 22.7.2016;

dh) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1084 prot., datë 15.2.2023 ndërmjet MAS-it dhe Institutit për Studimin e Krimeve të Komunizmit, "Për koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizmit të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1944-1990";

e) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1646 prot., datë 18.3.2021 ndërmjet MAS-it dhe Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të zbatimit të politikave arsimore dhe të formimit historik të nxënësve;

ë) Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4137/2 prot., datë 18.7.2024, "Për arsimimin e shtetasve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Republikën e Shqipërisë";

f) Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për edukimin patriotik dhe atdhetar të të rinjve në kuadër të programit "Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura", me nr. 5666/2 prot., datë 6.9.2024;

g) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4661/1 prot., datë 18.6.2015, objekt i së cilës është zbatimi i projektit "Mësime të shahut në shkolla";

gj) Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 3867 prot., datë 18.5.2026 ndërmjet Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe Albanian-American Development Foundation për zbatimin e programeve të "Junior Achievement of Albania";

h) Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës "Për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën "Gjuhë shqipe", klasa e 9-të, arsimi i mesëm i ulët parauniversitar";

i) Marrëveshja e Bashkëpunimit për Këshillimin e Karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar nr. 2996/2 prot., datë 05.05.2022, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë;

j) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 9322 prot., datë 12.11.2015 për zbatimin e projektit "Mësime të xhudos në shkolla";

k) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4073 prot., datë 18.4.2016, objekt i së cilës është zbatimi i projektit "Mësime të hendbollit në shkolla";

l) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 1660 prot., datë 12.12.2017, për zbatimin e projektit "Mësime të futbollit në shkolla (Growth 2020)";

ll) Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Organizatës Kombëtare Antidoping dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, regjistruar në MAS me nr. 1155/1 prot., datë 29.5.2023, për zbatimin e projektit "Ngritja e kapaciteteve për ndërgjegjësimin dhe edukimin antidoping në shkollë";

m) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2028/1 prot., datë 23.2.2018, për zbatimin e projektit "Mësime të basketbollit në shkolla";

n) Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet MA dhe UNFPA (2022-2026), datë 27.4.2022, nr. 412 prot., për zbatimin e programit të edukimit shëndetësor me fokus "Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor";

nj) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Korpusit të Paqes, datë 07.05.2019;

o) Marrëveshja - eTwinning NSO AL ndërmjet MA dhe Komisionit Evropian për zbatimin e programit eTëinning dhe programit Erasmus+ për arsim dhe edukim;

p) Memorandumi "Për edukimin përmes arteve dhe kulturës";

q) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Ministrisë së Arsimit nr. 3955/3 prot., datë 22.6.2026, "Për zhvillimin e veprimtarive informuese dhe sensibilizuese me nxënësit e arsimit parauniversitar për sigurinë ushqimore";

r) Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Shoqatës së Ujësjellës Kanalizime të Shqipërisë për:

i. Programin për fëmijë "Miqtë e ujit", nr. 2126/1 prot., datë 28.2.2018;

ii. Programin për fëmijë "Panairi shkencor për shkollat e mesme", nr. 2126/2 prot., datë 28.2.2018;

iii. Programin "Sfida botërore e monitorimit të ujit", miratuar me dokumentin nr. 2126/3 prot., datë 28.2.2018.

2. Institucionet arsimore parauniversitare mund të zhvillojnë edhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, institucione të arsimit të lartë, organizata të shoqërisë civile, partnerë zhvillimi dhe subjekte të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me miratimin e institucionit arsimor vendor përgjegjës.

## KREU VII
## VEPRIMTARI PLOTËSUESE DHE JASHTËSHKOLLORE

### Neni 27
### **Programi "Pas Shkolle"**

1. Në bazë të nenit 47/1 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AKAP/DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore parauniversitare planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë Programin "Pas Shkolle", të miratuar me vendimin nr. 627, datë 30.7.2026 të Këshillit të Ministrave.

2. Programi "Pas Shkolle" organizohet jashtë orarit mësimor dhe synon përforcimin e të nxënit, zhvillimin e aftësive akademike, sociale, kulturore, sportive dhe krijuese të nxënësve, si dhe mbështetjen e zhvillimit të tyre të gjithanshëm.

3. Organizimi dhe zhvillimi i programit "Pas Shkolle", kategoritë, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes, shpërblimi i trajnuesve, si dhe mënyra e financimit të këtij programi bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 30.7.2026.

4. Llojet e programit “Pas Shkolle”, standardet, kriteret, plani i veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimi i institucioneve publike të arsimit parauniversitar ku zhvillohet programi përcaktohen në bazë të urdhrit nr. 400, datë 31.7.2026, “Për miratimin e llojeve të programit “Pas Shkolle”, standardeve, kritereve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar”.

5. Programi “Pas Shkolle” zhvillohet në institucionet publike të arsimit parauniversitar, duke garantuar sigurinë, mirëqenien dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve.

6. Pjesëmarrja e nxënësve në program bëhet mbi bazën e kërkesës së prindit ose personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, përmes aplikimit në SMIP.

7. Shprehja e interesit, përzgjedhja dhe angazhimi i trajnuesve për programin “Pas Shkolle” realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

8. Programi “Pas Shkolle” organizohet nëpërmjet këtyre llojeve të programeve:

a) ”Bëjmë Detyrat e Shtëpisë” (BDSH) zhvillohet nga trajnues të diplomuar në fushën e mësuesisë apo në fusha të përafërta në një program të ciklit të dytë të studimeve, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo në institucione të huaja të arsimit të lartë, me diplomë të njohur dhe të njësuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

b) Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ) zhvillohen nga trajnues të diplomuar në fushën e mësuesisë apo në programe studimi të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndën e mësimdhënies në profilet artistike, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo në institucione të huaja të arsimit të lartë, me diplomë të njohur dhe të njësuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

9. Programi “Pas Shkolle” përfshin veprimtaritë dhe llojet e programeve sipas cikleve dhe zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar:

a) Në arsimin fillor, klasat 1-5 (AF): Bëjmë Detyrat e Shtëpisë (BDSH) dhe Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)

b) Në arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9 (AMU): Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)

c) Në arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12 (AML): Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)

10. Struktura dhe kohëzgjatja e veprimtarive organizohen si më poshtë:

a) BDSH për një grup zhvillohet 5 orë në javë (1 orë në ditë, 60 minuta x 5 ditë). Mësuesi i BDSH-së mund të zhvillojë deri në dy grupe, pra deri në 10 orë në javë.

b) KAZ për një klub zhvillohet 2 orë në javë (1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë).

i. Trajnuesi i KAZ-së, për AF, mund të zhvillojë deri në 2 grupe për 4 orë në javë.

ii. Trajnuesi i KAZ-së, për AMU, zhvillon vetëm një klub/grup për 1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë.

iii. Trajnuesi i KAZ-së, për AML, zhvillon vetëm një klub/grup për 1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë.

c) Trajnuesi i KAZ-së, sipas pikës b, mund të angazhohet në 2 cikle të arsimit bazë (AF+AMU) dhe deri në 2 institucione arsimore parauniversitare në javë.

11. Grupet e nxënësve për secilin lloj programi krijohen në përputhje me standardet, me një numër minimal prej 20 nxënësish dhe një numër maksimal prej 30 nxënësish pjesëmarrës, sipas përcaktimeve në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin.

12. Klubet e Arteve dhe Zejeve përfshijnë klubet e muzikës, kërcimit, teatrit,

artit pamor dhe klubet e zejeve.

13. Për secilin grup ose klub hartohet një plan pune me objektivat, temat, veprimtaritë dhe rezultatet e pritshme.

14. Institucioni arsimor publik harton planin vjetor për organizimin dhe zhvillimin e Programit “Pas Shkolle”, në përputhje me standardet dhe planin e veprimit të miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

15. Drejtori/nëndrejtori i institucionit arsimor publik organizon dhe koordinon zbatimin e Programit “Pas Shkolle”, miraton grupet/klubet e nxënësve dhe orarin e zhvillimit të veprimtarive, si dhe siguron kushtet e nevojshme për realizimin e programit.

16. Drejtori i institucionit arsimor monitoron zbatimin e programit dhe siguron respektimin e standardeve të miratuara.

17. Të dhënat për organizimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve, angazhimin e trajnuesve dhe realizimin e veprimtarive administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe përdoren për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Programit “Pas Shkolle”.

18. Frekuentimi i nxënësve dhe realizimi i veprimtarive regjistrohen në SMIP.

19. Në përfundim të vitit shkollor institucioni arsimor kryen vlerësimin e Programit “Pas Shkolle”, bazuar në pjesëmarrjen, rezultatet dhe ndikimin e tij tek nxënësit.

20. Programi “Pas Shkolle” nuk kufizon dhe nuk përjashton organizimin e veprimtarive të tjera plotësuese dhe jashtëshkollore, projekteve, partneriteteve dhe nismave edukative, kulturore, sportive apo sociale, të zhvilluara nga institucionet arsimore në bashkëpunim me institucione publike, organizata të shoqërisë civile, partnerë zhvillimi ose subjekte të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

21. Programi “Pas Shkolle” mbështetet dhe pasurohet edhe me veprimtaritë edukuese në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për edukimin përmes arteve dhe trashëgimisë kulturore midis MA-së dhe MTKS-së.

Neni 28

**Shkolla Qendër Komunitare**

1. Të konsolidohen shkollat qendra komunitare (ShQK), bazuar në standardet e shkollës si qendër komunitare.

2. ShQK-ja organizohet jashtë orarit mësimor dhe synon bashkëpunimin me aktorët në komunitet dhe me prindërit, me fokus mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve, përmirësimin e arritjeve të tyre, mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e komuniteteve.

3. Shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët, si Save the Children, Ëorld Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e ShQK-së dhe të bashkëpunohet për përmbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.

4. ShQK-ja organizon klube dhe veprimtari komunitare, në përputhje me interesat e nxënësve, nevojat e komunitetit, burimet e shkollës dhe standardet e Shkollës Qendër Komunitare.

5. Në kuadër të veprimtarive të ShQK-së, institucionet arsimore zbatojnë nismën “Toka në shkollë”, në përputhje me udhëzuesin përkatës të miratuar nga MAS, duke e përdorur kopshtin e shkollës si mjedis edukativ për zhvillimin e kompetencave praktike, edukimin mjedisor dhe bashkëpunimin me komunitetin.

6. Drejtori i institucionit arsimor cakton koordinatorin e Shkollës Qendër Komunitare dhe miraton planin vjetor të veprimtarive.

7. AKAP/DRAP/ZVAP:

a) Në fund të vitit shkollor kryejnë vlerësimin e Shkollave Qendër Komunitare (ShQK) në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara dhe miratuara;

b) marrin masat e nevojshme për këshillimin, informimin, trajnimin dhe rritjen profesionale të mësuesve koordinatorë, strukturave drejtuese të shkollës dhe grupimeve të komunitetit, në bashkëpunim me ASCAP-in dhe partnerët strategjikë;

c) promovojnë në mënyrë proaktive praktikat më të mira të ShQK-ve dhe krijojnë rrjete dypalëshe apo rajonale për shkëmbimin e përvojave të suksesshme mes shkollave;

ç) monitorojnë dhe vlerësojnë menaxhimin sa më efektiv dhe me impakt të 10 orëve javore të planifikuara posaçërisht për veprimtaritë e ShQK-së;

d) mbështesin bashkëpunimin e Shkollave Qendër Komunitare me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, partnerët strategjikë dhe komunitetin, në funksion të zhvillimit të veprimtarive edukative dhe forcimit të rolit të shkollës si qendër komunitare;

dh) identifikojnë dhe propozojnë për miratim deri më 30 qershor 2027 pranë MA-së institucione arsimore që plotësojnë kriteret për t'u kthyer në Shkollë Qendër Komunitare.

8. MA, brenda datës 15 korrik 2027, miraton për zbatim listën e institucioneve arsimore që plotësojnë kriteret për t'u kthyer në Shkollë Qendër Komunitare.

Neni 29

**Olimpiada dhe konkurse**

1. Në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, AKAP/DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore të planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:

a) Olimpiadat kombëtare në AMU dhe AML;

b) Konkursi Kombëtar për klasat IX, "Gjurmët e Shqipes", një udhëtim në gjuhë, letërsi, histori dhe kulturë shqiptare;

ç) Festivalin Kombëtar të Shkencës për AML;

d) Konkursin e Koreve për AMU;

dh) Festivalin e teatrit për fëmijë në AMU në bashkëpunim me Qendrat Kulturore të Fëmijëve.

2. AKAP harton dhe publikon kalendarin vjetor të zhvillimit të olimpiadave, konkurseve dhe festivaleve kombëtare.

3. Olimpiada e Përbashkët me Kosovën për Gjuhën Shqipe, klasa e 9-të.

Neni 30

**Veprimtari të tjera plotësuese**

Në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, AKAP/DRAP/ZVAP-të dhe institucionet arsimore të planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:

1. "Medalja e artë" për nxënësit e shkëlqyer, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitin shkollor 2025-2026;

2. Kampionatet sportive të organizuara nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, në kuadër të Programit të Ekipeve Sportive në Shkolla;

3. Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars-prill 2027;

4. Java Evropiane e Sportit, 23-30 shtator 2026;

5. Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2026;

6. Muaji i ndërgjegjësimit për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, tetor 2026;

7. Muaji i Letërsisë dhe i Arteve – Lëvizja "Takohemi për një libër 2.0", tetor 2026;

8. Dita Globale e Etikës, e mërkura e tretë e muajit tetor;

9. Dita Botërore e Gjuhës Rome, UNESCO, 5 nëntor 2026;

10. Në kuadër të vitit evropian të edukimit për qytetarinë digjitale (2026), më 16 nëntor 2026 të zhvillohen aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese;

11. Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2026;

12. Dita e Luftës Kundër Bullizmit, 21 nëntor 2026;
13. Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, 3 dhjetor 2026;
14. Dita e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, 10 dhjetor 2026;
15. Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve, UNESCO, 18 dhjetor 2026;
16. Dita Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, 24 janar 2027;
17. Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2027;
18. "Java e Këshillimit të Karrierës", 1-5 shkurt 2027, për orientimin dhe këshillimin e nxënësve për zgjedhjet e tyre arsimore dhe profesionale;
19. Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2027;
20. Dita Ndërkombëtare e Matematikës, UNESCO, 14 mars 2027;
21. Dita Botërore e Poezisë, UNESCO, 21 mars 2027;
22. Dita Botërore e Ujit, UNESCO, 22 mars 2027;
23. Dita Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2027;
24. Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2027;
25. Dita Botërore e Tokës, 22 prill 2027;
26. Dita Botërore e Librit, 23 prill 2027;
27. Java Olimpike (prill-maj 2027);
28. Dita Ndërkombëtare e eTwinning, 7 maj 2027;
29. Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, UNESCO, 16 maj 2027;
30. Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim, UNESCO, 21 maj 2027;
31. Dita Botërore e Mjedisit, UNESCO, 5 qershor 2027;
32. Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2027;
33. Dita Ndërkombëtare e Rinisë, UNESCO, 12 gusht 2027;
34. Dita Evropiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2027;
35. Kalendari i Ditëve të Evropës dhe veprimtaritë gjithëvjetore për njohjen e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës;
36. Konkurset në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me tematikë, "Të njohim Evropën";
37. Ditët e festave kombëtare;
38. Aktivitete për data dhe ngjarje të shënuara në nivel rajonal dhe lokal;
39. Veprimtari të tjera edukative, kulturore, sportive, shkencore dhe qytetare, të organizuara nga institucionet arsimore në përputhje me prioritetet kombëtare, rajonale dhe vendore.

## KREU VIII
## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 31
### **Institucionet që ngarkohen për marrjen e masave dhe zbatimin e këtij Udhëzimi**

1. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale dhe vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare, për zbatimin e këtij udhëzimi.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin masat e nevojshme që ky udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor parauniversitar dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT

**Mirela Kumbaro Furxhi**

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
**Delina Ibrahimaj**